VENDIM
Nr.1121, datë 13.11.2009

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR SHPËRBLIMIN E PESHËNGRITËSVE, ROMELA BEGAJ E ERKAND QERIMAJ, DHE TË TRAJNERËVE TË TYRE, HEKTOR SHAQIRI E ZEF KOVAÇI, PËR REZULTATET E LARTA, QË KANË ARRITUR NË LOJËRAT MESDHETARE, PESCARA 2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri "Projekte", artikulli "604", t'i shtohet fondi 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për shpërblimin e peshëngritësve, Romela Begaj e Erkand Qerimaj, dhe të trajnerëve të tyre, Hektor Shaqiri e Zef Kovaçi, për rezultatet e larta të arritura në Lojërat Mesdhetare, Pescara 2009, zhvilluar në datat 26 qershor-5 korrik, në Itali, sipas preventivit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PREVENTIV

Në sportin e peshëngritjes në Lojërat Mesdhetare, zhvilluar në datat 26 qershor-5 korrik 2009 në Pescara Itali u arritën rezultatet e mëposhtme:

Peshëngritësja Romela Begaj, fituese e vendit të parë, Medalje Ari në shkëputje.
Shuma e shpërblimit prej 1 000 000 lekë.
Peshëngritësi Erkand Qerimaj, fitues i vendit të parë, Medalje Ari në shkëputje.
Shuma e shpërblimit prej 1 000 000 lekë.
Trajneri i sportistes Romela Begaj, z. Hektor Shaqiri
Shuma e shpërblimit prej 300 000 lekë.
Trajneri i sportistit Erkand Qerimaj, z. Zef Kovaçi
Shuma e shpërblimit prej 300 000 lekë.
Totali 2 600 000